



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 mars 2020
Nr. ref.:RK1524/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI126/18

Parashtrues

Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 197/2018, të 13 qershorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili fillimisht përfaqësohej nga Ahmet ef. Hoxha, Kryetar i Bashkësisë Islame në Gjakovë dhe më pas nga avokati Teki Bokshi nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 197/2018] e 13 qershorit 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 1870/13] e 16 marsit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 324/2008] e 2 prillit 2013 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i cili, sipas pretendimit, shkelë të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me paragrafin 2 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës, dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 17 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 28 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Në të njëjtën datë, Gjykata njoftoi edhe Komunën e Gjakovës, në cilësinë e palës së interesuar, për regjistrimin e kërkesës duke i ofruar mundësinë që të paraqesë komente lidhur me kërkesën KI126/18 brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit të Gjykatës.

9. Më 28 shtator 2018, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
10. Më 5 tetor 2018, Komuna e Gjakovës dorëzoi komentet e saj në Gjykatë përkitazi me kërkesën. Ajo po ashtu bashkëngjiti edhe disa dokumente shtesë në mbështetje të komenteve të saj (shih paragrafët 53-57 për komentet e paraqitura në Gjykatë nga Komuna e Gjakovës).
11. Më 9 tetor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për komentet e pranuar nga Komuna e Gjakovës lidhur me kërkesën KI126/18. Gjykata ia bashkëngjiti një kopje të atyre komenteve për informatën e saj.
12. Më 22 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë komente lidhur me komentet e dorëzuara nga Komuna e Gjakovës. Ai po ashtu bashkëngjiti edhe disa dokumente shtesë në mbështetje të kërkesës së tij fillestare (shih paragrafët 58-61 për komentet shtesë të paraqitura në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës).
13. Më 26 tetor 2018, Gjykata e njoftoi Komunën e Gjakovës për komentet shtesë të pranuar nga parashtruesi i kërkesës si përgjigje ndaj komenteve të Komunës së Gjakovës të 5 tetorit 2018. Gjykata ia bashkëngjiti një kopje të atyre komenteve për informatën e tyre.
14. Më 19 nëntor 2018, Komuna e Gjakovës dorëzoi një përgjigje shtesë mbi komentet shtesë të parashtruesit të kërkesës (shih paragrafët 62-66 për komentet e paraqitura në Gjykatë nga Komuna e Gjakovës).
15. Më 13 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë: (i) kopjen e padisë së parashtruar në Gjykatën Themelore; (ii) kopjen e ankesës së dorëzuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit; si dhe (iii) kopjen e kërkesës për revizion të dorëzuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme.
16. Më 23 shtator 2019, nëpërmjet postës, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet shtesë të kërkuara nga Gjykata.
17. Më 3 tetor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ka pranuar dokumentacionin shtesë si dhe i dërgoi një kopje të komenteve shtesë të pranuar nga Komuna e Gjakovës më 19 nëntor 2018 si përgjigje ndaj komenteve shtesë të saj të 22 tetorit 2018. Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës se komentet në fjalë po iu bashkëngjiten vetëm për informatën e tyre duke qenë se periudha e komentimit tashmë ka përfunduar dhe se Gjykata është në proces të shqyrtimit të rastit.
18. Më 3 tetor 2019, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Themelore dhe atë të Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe iu dërgoi nga një kopje të kërkesës. Nga Gjykata Themelore, Gjykata po ashtu kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë që ndërlidhet me rastin KI126/18 në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga momenti i pranimit të shkresës së Gjykatës.

19. Më 9 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një autorizim për përfaqësim përmes së cilit e njoftoi Gjykatën që në procedurat e mëtejme pranë saj zgjedh të përfaqësohet nga avokati Teki Bokshi.
20. Më 10 tetor 2019, Gjykata Themelore e dorëzoi dosjen e plotë në Gjykatë.
21. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Padia e parashtruesit të kërkesës kundër Komunës së Gjakovës

22. Më 16 prill 1997, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi kundër Komunës së Gjakovës në Gjykatën e atëhershme Komunale në Gjakovë. Objekti i padisë kishte qenë “kompensimi i dëmit për konfiskim të pronës pa kompensim” nga ana e Komunës së Gjakovës, për qëllime të nevojave publike. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se pronat në fjalë, dy dyqane, siç do të shpjegohet tutje në pjesën e fakteve, i ishin marrë pa procedurë të duhur ligjore dhe pa kompensim. Për rrjedhojë, ai kishte kërkuar nga Gjykata e atëhershme Komunale e Gjakovës që t’i jepet një pronë tjetër si formë e kompensimit në natyrë për pronën e marrë – ose t’i kompensohet kjo humbje në vlerë monetare respektive.
23. Nga shkresat në dosjen origjinale të lëndës, rezulton që gjykatat e asaj kohe nuk kanë vendosur asnjëherë meritorisht mbi padinë e parashtruesit të kërkesës.
24. Më 17 shkurt 2003, duke qenë se padia e parashtruesit të kërkesës nuk ishte vendosur, ai i propozoi Gjykatës Komunale në Gjakovë që të vazhdojë procedurën për shqyrtimin e padisë së tij të vitit 1997. Nga dosja origjinale e lëndës rezulton që janë mbajtur disa seanca gjyqësore për shqyrtimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës si dhe është bërë shikimi i vendit të ngjarjes dhe janë zhvilluar ekspertiza gjeodezike për të determinuar faktet e rastit.
25. Më 12 nëntor 2012, pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë, u mbajt shqyrtimi kryesor lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Në këtë seancë, parashtruesi i kërkesës e precizoi padinë e tij duke kërkuar që të detyrohet Komuna e Gjakovës që ta kompensojë në shumë totale prej 17,750.00 euro për dy ngastra kadastrale të cilat ndodheshin në qendër të qytetit të Gjakovës [4,750.00 euro për ngastrën kadastrale nr. 2549 me sipërfaqe prej 19 m²; dhe 13,000.00 euro për ngastrën kadastrale nr. 2556 me sipërfaqe prej 52 m²]. Parashtruesi i kërkesës pretendonte që është pronar i këtyre dy ngastrave, të regjistruara në emër të tij, por se të njëjtat iu ishin marrë pa procedurë adekuate dhe pa kompensim. Të njëjtat ngastra kadastrale, të cilat janë objekt kryesor i kontestit në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Komunës së Gjakovës, në të kaluarën kishin qenë dyqane ndërkaq sot ato janë trotuare, rrugë publike, në rrugën “Nëna Terezë” në Gjakovë.

26. Komuna e Gjakovës, si përgjigje ndaj kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, në seancën e shqyrtimit kryesor, kishte deklaruar se e kundërshton atë në tërësi dhe se parashtruesit të kërkesës i mungon legjitimiteti për të qenë palë në këtë kontest dhe se, për më tepër, sipas Komunës së Gjakovës, parashtruesi i kërkesës është vonuar në ushtrimin e padisë në fjalë dhe si rrjedhojë kërkesa e tij ka arritur statusin e “*parashkrimit absolut*”.

Vendimmarrja në Gjykatën Themelore

27. Më 2 prill 2013, tashmë Gjykata Themelore dhe jo ajo Komunale, përmes Aktgjykimit [A. nr. 1144/14] e refuzoi si të pathemeltë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Komunës së Gjakovës. Fillimisht, Gjykata Themelore sqaroi faktin se ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte jokontestues fakti se ngastrat kadastrale objekt kontesti, në vitin 1956 janë shndërruar në trotuar të rrugës “Nëna Terezë” dhe se në gjendje të tillë, pra si trotuare, ekzistojnë dhe sot. Tutje, Gjykata Themelore sqaroi se nëpërmjet Historiatit [nr. 952-03-3/12 të 28 janarit 2010] të hartuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, i cili është nxjerrë si provë në seancën kryesore shqyrtuese, është konstatuar se ngastrat kadastrale objekt kontesti “*janë evidencuar në emër të pasurisë e Vakufit Gjakovë*”. Gjatë vitit 1955, sqaron Gjykata Themelore, është kryer reambulimi dhe ngastrat kadastrale në fjalë “*janë evidencuar në emër të pasuri e Bashkësisë së Fesë Islame në Gjakovë, gjendje kjo e pa ndryshuar gjer në ditën e sotme*”.
28. Më specifikisht, Gjykata Themelore arsyetoi se: “[...] *paditësi [parashtruesi i kërkesës] fillimisht është dashur që me kërkesëpadi të argumentoj se është pronar e paluajtshmërisë lëndore për të cilën ka kërkuar kompensim që do të thotë se paditësi është dashur që të ushtroj padi për vërtetim pronësie dhe kthimin e saj. Mirëpo, kështu nuk ka vepruar, pavarësisht faktit se e njëjta nuk gjendet në posedim të paluajtshmërisë lëndore që në vitin 1956, ndërsa padinë lëndore e ka ushtruar më dt. 14.05.1997 dmth pas 41 viteve, kur është privuar nga e drejta e pronësisë dhe posedimit të paluajtshmërisë lëndore, prej nga rezulton se është i bazuar pretendimi i përfaqësuesit ligjor të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, dhe një pretendim të tillë kjo Gjykatë vlerëson se ka mbështetje në dispozitën e nenit 371 të LMD-së (ndryshimet e LMD-së të publikuara në Gz. të RFJ-së nr. 31/93 të dt. 18.06.1993) ligj ky i aplikuar në Kosovë sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24. Për këto arsye kërkesëpadia e precizuar e paditësit u tregua si e pathemeltë dhe si e tillë u refuzua*”.

Vendimmarrja në Gjykatën e Apelit

29. Më 16 maj 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit, për shkak të cenimit të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës së Apelit që ta miratojë ankesën dhe ta kthejë çështjen në rishqyrtim apo ta modifikojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke e aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë.

30. Më 16 mars 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC. nr. 1870/2013] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe, për rrjedhojë, vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
31. Për sa i takon pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata e Apelit mbështeti vendimmarrjen e Gjykatës Themelore në atë drejtim duke arsyetuar me sa vijon: *“Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se thëniet ankimore të përfaqësuesit të paditësit, për cenime të dispozitave të LPK-së, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë së precizuar të palës paditëse, e cila i referohet kompensimit të dëmit kundërvlerës për pagesën e shumave të cekura si në kërkesëpadi nga e paditura Komuna e Gjakovës, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale nga dispozita e nenit 182 par. 2 të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar [të Gjykatës Themelore]. Prandaj, në situatën konkrete janë të pabazuara pretendimet ankimore, për shkelje të dispozitës së nenit 20 paragrafi 1, 37, 33 dhe 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësoresh Juridike, sepse të gjitha këto dispozita i referohen çështjeve pronësore, ndërsa nga ana e paditëses në rastin konkret është kërkuar kompensimi-kundërvlera për ngastrat me nr. 2549 ZK Gjakovë-Qytet, me kulturë ish-dyqan, tani pllato-trotuari i rrugës "Nëna Terezë" si dhe për ngastrat me nr. 2556 ZK Gjakovë-Qytet, me kulturë ish-dyqan, tani pllato-trotuari i rrugës "Nëna Terezë", në shumën e caktuar dhe detajet tjera si në dispozitivin e Aktgjykimit të atakuar [të Gjykatës Themelore]”.*
32. Për sa i takon pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit mbështeti vendimmarrjen e Gjykatës Themelore në atë aspekt duke arsyetuar me sa vijon: *“Gjithashtu, edhe sa i përket pretendimit për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, sipas Gjykatës së Apelit një pretendim i tillë i paditësit është i pabazuar, sepse gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me këtë çështje juridike, ka administruar provat dhe ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me prova bindëse, përfshirë këtu edhe ekspertizën e gjeodezisë dhe daljen e gjykatës në vend shikim dhe ka marrë vendimin e ligjshëm dhe të drejtë, duke pasur parasysh faktin se përfaqësuesi i të paditurës është thirrur në parashkrimin e kërkesës dhe gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar një pretendim të tillë, ashtu që duke zbatuar dispozitat përkatëse ligjore siç është ajo e nenit 371 të LMD-së me ndryshimet e bëra [...]. Ashtu siç ka konkluduar edhe gjykata e shkallës së parë, paditësi që nga viti 1956 nuk ka ushtruar ndonjë kërkesëpadi që të argumentoj se është pronar i paluajtshmërisë lëndore, për të cilën tani kërkon kompensimin, e as që ka ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë dhe kthimin e saj, edhe përkundër faktit se e njëjta nuk ka qenë në posedim të paluajtshmërisë lëndore që nga viti 1956, por tek me datën 14.05.1997, pra, pas 41 viteve ushtron padi për kompensim të paluajtshmërisë, duke kërkuar edhe kamatën ligjore. Andaj, duke u nisur nga fakti se e paditura [Komuna e Gjakovës] është thirrur në parashkrimin e kërkesës, atëherë gjykata e shkallës së parë duke qenë para një gjendje të tillë faktike, drejtë ka konkluduar se*

kërkesa e paditësit është e parashkruar dhe pretendimin e përfaqësuesit ligjor të paditurës e ka konsideruar si të bazuar”.

33. Në fund, Gjykata e Apelit lidhur me pretendimet e tjera ankimore të parashtruesit të kërkesës, theksoi: *“Nuk qëndron pretendimi ankimor i përfaqësuesit të paditësit, se kanë kaluar më tepër se 20 vite prej kur e paditura pa procedurë juridike-administrative i ka uzurpuar dy dyqanet për rrugë pa kompensim apo ndonjë formë tjetër të kompensimit, sepse, në rastin konkret kërkesëpadia është orientuar në kompensimin për paluajtshmërinë e cila është në posedim dhe shfrytëzim të paditurës. Paditësi një kërkesë të tillë siç u theksua edhe më lart, e ka bërë pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor dhe situata e tillë nuk mund të kthehet prapa, kështu që në rastin konkret nuk ekziston kërkesëpadi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, por vetëm për kompensim të kundërvlerës të ngastrave të paditësit të cilat siç u tha edhe më lart që nga viti 1956 janë në posedim dhe shfrytëzim të paditurës, Komunës së Gjakovës. Duke pasur parasysh faktin se në rastin konkret ekziston parashkrimi absolut i kërkesëpadisë Gjykata e Apelit vlerësoi se pretendimet ankimore të paditësit janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, andaj si të tilla u refuzuan në tërësi”.*

Vendimmarrja në Gjykatën Supreme

34. Më 18 prill 2018, parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme, me propozim që aktgjykimet e dy gjykatave më të ulëta të ndryshohen dhe të miratohet kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës si tërësisht e bazuar; ose, të prishen aktgjykimet e dy gjykatave më të ulëta dhe çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore. Revizionin në fjalë, parashtruesi i kërkesës e paraqiti për tri arsye thelbësore, respektivisht mbi bazën e tri pretendimeve kryesore.
35. Pretendimi i parë i parashtruesit ishte për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, respektivisht shkelje të nenit 182.1, pika n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: “LPK”) ngase, sipas pretendimit, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ka pasur të meta, ka qenë kontradiktor me arsyet dhe nuk ka pasur arsye për faktet vendimtare.
36. Pretendimi i dytë i parashtruesit ishte për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që janë bërë nga Gjykata e Apelit në shkallë të dytë meqenëse, sipas pretendimit, nuk janë analizuar pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë.
37. Pretendimi i tretë i parashtruesit ishte për aplikim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me të cilën parashtruesi i kërkesës pretendonte se ai nuk e ka humbur asnjë të drejtë për shkak se shteti ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe, për rrjedhojë, janë nule të gjitha veprimet për privimin e tij nga e drejta e posedimit të ngastrave kontestuese. Më tutje, parashtruesi i kërkesës theksoi se ngastrat kontestuese janë “pronë” e tij dhe se të njëjtat *“sot e kësaj dite evidencohet në emër të paditësit [parashtruesit të kërkesës]. Paditësi është i ngarkuar me taksa dhe tatime për këtë pronë. Fakti që organi shtetëror, duke shkelur të drejtat elementare qytetare, të drejtat elementare të*

njeriut, ajo shkelje nuk do të duhet të shpërblehej në favor të shtetit, në këtë rast komunës”.

38. Tutje, lidhur me këtë pretendim, parashtuesi i kërkesës theksoi në kërkesë për revizion se: *“Refuzimi i padisë është shpërblim shtetit pse i ka shkelur të drejtat elementare të njeriut paditësve, të komunitetit mysliman, të kësaj Bashkësie fetare e cila juridikisht është person juridik qytetar. Tash, në liri, në rrethana krejt të ndryshuara, në rrethana kur Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut është në aplikim në Kosovë dhe një mori dokumenteve ndërkombëtare [...] Kjo mënyrë e privimit nga prona e shtetasve për kohën e cituar ka qenë sjellje e zakonshme e pushtetit të asokohshëm. Në gjithë botën ish-komuniste, përkatësisht socialiste pronat e marrura nga shteti totalitar, pronat e qytetareve iu janë kthyer. Privimi nga pronat posaçërisht ka qenë i theksuar në Kosovë ndaj shqiptarëve, për shkak të politikës shtetërore antishqiptare të asaj kohe, që ka pasur program që shqiptarët të provohen nga pronat duke bërë presion që të shpërngulen në Turqi. Në situatën e tanishme të një realiteti krejtësisht tjetër, pronat duhet të kthehen ish-pronarëve”.* Për sa i takon çështjes së kthimit të pronës, parashtuesi i kërkesës theksoi para Gjykatës Supreme se ajo duhet të ketë parasysh Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe në veçanti nenin 8.6 ku parashihet se Kosova duhet t’i trajtojë me prioritet të gjitha çështjet e kthimit të pronave. Në këtë drejtim, parashtuesi theksoi se gjykatat e nivelit më të ulët nuk kanë marrë parasysh nenin 46 të Kushtetutës i cili, sipas tij, duhet të interpretohet në bazë të Propozimit të lartcekur për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.
39. Në fund të revizionit të paraqitur pranë Gjykatës Supreme, parashtuesi i kërkesës theksoi me sa vijon: *“Duhet pasur parasysh edhe faktin se komuna, si organ shtetëror, e ka pasur të njohur dhe duke ditur se ajo është pronë e huaj, pronë private, nuk ka zbatuar procedurën e eksproprijimit ashtu që ajo është në posedim joligjor të pronës private, paraprakisht duhej të eksproprijoheshin nga pronari privat dhe i njëjti të kompensohet dhe se ato veprime imperative ligjore nuk i ka ndërmarrë, ajo është palë në keqbesim, palë e pa ndërgjegjshme, mbajtës i pandërgjegjshëm dhe joligjor, dhe duhet të bartë pasojat e kundërligjshmërisë”.*
40. Më 13 qershor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 197/2018] e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtuesit për revizion – duke konfirmuar kështu në tërësi vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit dhe të asaj Themelore.

Pretendimet e parashtuesit të kërkesës

41. Parashtuesi i kërkesës, duke u thirrur në paragrafin 2 të nenit 22 të Kushtetutës ku parashihet zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e KEDNJ-së në Republikën e Kosovës dhe nenin 53 të Kushtetutës ku parashihet obligimi për interpretimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme dhe aktgjykimet e dy gjykatave të tjera të rregullta, asaj të Apelit dhe Themelore, iu janë shkelur të drejtat e saj për: (i) gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenet 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (ii) mbrojtje të pronës të

garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iii) për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës.

Lidhur me pretendimet për nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

42. Së pari, lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pohon se kjo e drejtë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të cituar nga parashtruesi i kërkesës (shih, *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykim i 22 shkurtit 2017, paragrafi 58; dhe *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33), ngërthen në vetvete edhe parimin e administrimit të duhur të drejtësisë sipas të cilit “*vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të tregojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato janë bazuar*”. Gjykatat, thekson parashtruesi i kërkesës, sipas GJEDNJ-së, ndonëse kanë liri të konsiderueshme në zgjidhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre janë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, ato, megjithatë, e kanë për obligim që “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*”.
43. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta ia kanë shkelur të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor përmes mangësisë së analizës dhe duke mos iu marrë për bazë pretendimet ankimore të cilat “*në esencë nuk janë shqyrtuar*”. Ai pohon se në ankesë para Gjykatës së Apelit dhe në revizion para Gjykatës Supreme ka deklaruar se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme nga gjykata e shkallës së parë. Në arsyetimin e Gjykatës Supreme ku thuhet se: “*gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në këtë çështje juridike që ka të bëjë me parashkrimin e kërkesës së paditësit për pagesë të kundërvlerës së ngastrave lëndore, të cilat arsye i pranon edhe gjykata e revizionit, andaj e panevojshme që edhe tani të përsëriten*”, është bërë interpretim i njëanshëm i ligjit gjë të cilën, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme nuk ka të drejtë ta bëjë.
44. Konstatimi i Gjykatës Supreme se: “*këtu paditësi paditë vetëm për kompensim të kundërvlerës edhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë në këto ngastra, e cila çështje është dashtë të paraqitet si çështje paraprake për të vendosur për kompensimin e kundërvlerës së ngastrave lëndore*” – është një konstatim krejtësisht i pamundur sipas parashtruesit të kërkesës ngase paditësit, respektivisht parashtruesit të kërkesës iu është refuzuar kërkesa për shkak të parashkrimit dhe se gjykatat e rregullta “*nuk kanë thënë se Këshilli i Bashkësisë Islame Gjakovë nuk është pronar, nuk ka legjitimitet aktiv, po se kërkesa është parashkruar*”.

Lidhur me pretendimet për nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

45. Së dyti, lidhur me të drejtën për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pohon se Këshilli i Bashkësisë Islame [parashtruesi i kërkesës] “*ka*

qenë dhe vazhdon të jetë i regjistruar si pronar i ngastrës kadastrale a) nr. 2549, me kulturë dyqan, në sipërfaqe prej 19 m², ZK Gjakovë – qytet, i cili dyqan është rrënuar njëanshmërisht dhe është shndërruar në pllato, trotuar dhe përdorët për nevoja publike” dhe, po ashtu, pronar i ngastrës kadastrale “b) nr. 2556, me kulturë dyqan, në sipërfaqe prej 52 m², ZK Gjakovë – qytet, që po ashtu është rrënuar njëanshmërisht dhe është shndërruar në pllato, trotuar [ngastrat objekt kontesti]” dhe përdoret për nevoja publike.

46. Parashtruesi i kërkesës pohon se këtë çështje nuk ka arritur ta zgjidhë në procedurë jashtëgjyqësore siç parashihej me Ligjin për Eksproprijimin e Kosovës (Gazeta Zyrtare e KSAK-së 21/78), dhe me Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë iu është dashur që të iniciojnë kontest gjyqësor *“me shpresë që autoritetet gjyqësore të Republikës së Kosovës do të vendosin drejtshmëri”* duke pasur parasysh që *“sistemi komunist ka kaluar e edhe ai i dominimit të pushtetit të huaj diskriminues, antikombëtar dhe antifetar”*.
47. Parashtruesi i kërkesës thekson se në procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta, asaj Themelore, të Apelit dhe Supreme, *“është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se prova se prona është e Këshillit të Bashkësisë Islame, se është pronë vakfnore dhe se e njëjta nga lokalet afariste të cilat janë rrënuar dhe shndërruar në trotuare për nevoja publike, se ajo është si pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame është e regjistruar dhe se as që është zhvilluar procedura ligjore Detyrimore për shpronësimin e pronës private për nevoja publike dhe se nuk është filluar fare procedura e kompensimit, detyrim që parashihej dhe parashihet dhe sot, por kërkesa iu është refuzuar për shkak të parashkrimit”*.
48. Në këtë çështje, sipas parashtruesit të kërkesës, *“parashkrim nuk ka”*. Parashkrimi, thekson ajo, fillon pasi që kërkesa bëhet e arritshme dhe se parashkrimi do të fillonte po të ishte caktuar lartësia e kompensimit me vendim administrativ apo me vendim gjyqësor. *“Nëse organet komunale, përkatësisht autoritetet publike, e kanë shpronësuar Këshillin e Bashkësisë Islame nga prona e saj dhe atë pastaj e kanë destinuar për nevoja publike, është faji i autoriteteve publike që nuk kanë zbatuar detyrimet ligjore, nuk kanë iniciuar procedurën e eksproprijimit, përkatësisht të shpronësimit”*.
49. Sipas parashtruesit të kërkesës, është *“praktikë e kristalizuar gjyqësore”* se kërkesat për kompensimin e pronës private të eksproprijuar për nevoja publike nuk parashkruhen. Në këtë aspekt, aktgjykimet e gjykatave të rregullta që e kanë bazuar vendimin e tyre në parashkrim të kërkesës, *“nuk kanë dhënë arsye të qarta lidhur me pretendimet ankimore dhe të revizionit”*. Tutje, vazhdon parashtruesi i kërkesës se ajo nuk ka pasur mundësi të kërkojë vërtetimin e pronësisë ngase nga pronësia është privuar dhe shpronësuar në mënyrë arbitrare ngase nuk është kontestuese se dyqani prej 19 m² dhe ai prej 52 m² është trotuar dhe rrugë në sheshin “Nëna Terezë” në qendër të qytetit të Gjakovës. Nuk ka asnjë mënyrë që të vërtetohet e drejta e pronësisë në dyqane kur ajo paluajtshmëria është trotuar. Andaj, as Gjykata Supreme, e as ato më të ulëta, sipas pretendimit, *“nuk kanë arsyetuar aktgjykimet, kanë vepruar me njëanshmëri, kanë shkelur të drejtën e pronës”*.

50. Parashtruesi i kërkesës e përfundon arsyetimin e tij duke theksuar se *“këto prova për Bashkësinë e Fesë Islame janë shumë të rëndësishme, pasi që të njëjtat i janë lënë në pronësi Bashkësisë Islame dhe besimtarëve të saj, në mënyrë që Bashkësia Islame të krijojë mundësi që të zhvillojë misionin e saj”*.
51. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet paragrafit 2 të nenit 22 të Kushtetutës si dhe neneve 53 dhe 54 të Kushtetutës, pa dhënë ndonjë sqarim shtesë lidhur me këto nene.
52. Krejt në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që:
- (i) Të deklarojë kërkesën të pranueshme;
 - (ii) Të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së;
 - (iii) Të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme dhe aktgjykimet e tjera të gjykatave të instancave më të ulëta që i kanë parapri këtij aktgjykimi;
 - (iv) Ta kthejë Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Komentet e para të Komunës së Gjakovës të 5 tetorit 2018

53. Komuna e Gjakovës, në cilësinë e palës së interesuar, dorëzoi komente në Gjykatë pas mundësisë që i dha kjo e fundit.
54. Komuna e Gjakovës theksoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme duke qenë se ajo nuk ka arritur që të prezantojë prova materiale të cilat do të dëshmonin bazueshmërinë e kërkesës së dorëzuar para Gjykatës Kushtetuese.
55. Sipas Komunës së Gjakovës, Gjykata Themelore ka vendosur drejtë dhe bazuar në dispozitat e ligjit në fuqi dhe *“duke u bazuar në rrethanat jokontestuese dhe provat e administruara ka vlerësuar se paditësi fillimisht është dashur që me kërkesëpadi të argumentojë se është pronar i paluajtshmërisë lëndore për të cilën ka kërkuar kompensim, që do të thotë se paditësi është dashur të ushtrojë padi për vërtetimin e pronësisë dhe kthimin e saj”*. Mirëpo, duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar pavarësisht faktit se nuk është posedues i pronës kontestuese që nga viti 1956 por që padinë e ka ushtruar 41 vite më pas, respektivisht më 14 maj 1997 rezulton se ai *“është privuar nga e drejta e pronësisë dhe posedimit të paluajtshmërisë lëndore, prej nga rezulton se është i bazuar pretendimi i përfaqësuesit ligjor të të paditurës [Komunës së Gjakovës] lidhur me parashkrimin e kërkesës”*, sipas nenit 371 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (Ndryshimet e LMD-së të publikuara në Gz. e RFJ-së nr. 31/93, të 18 qershorit 1993), Ligj ky i aplikuar në Kosovë sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, për këto arsye kërkesëpadija e precizuar e paditësit u tregua si e pathemeltë dhe si e tillë u refuzua.
56. Edhe Gjykata e Apelit, thekson Komuna e Gjakovës, e ka vërtetuar vendimmarrjen e Gjykatës Themelore me ç’rast ka vlerësuar se pretendimet

ankimore të parashtruesit të kërkesës nuk qëndrojnë *“ngase në rastin konkret ekziston parashkrimi absolut i kërkesëpadisë”*. Po ashtu, edhe Gjykata Supreme, sipas Komunës së Gjakovës, me të drejtë e ka pranuar si të bazuar qëndrimin juridik të dy gjykatave më të ulëta me faktin se është parashkruar kërkesa e parashtruesit për të kërkuar që të obligohet Komuna e Gjakovës për të paguar kundërvlerën e ngastrave kontestuese kadastrale dhe kjo bazuar në nenin 371 të LMD-së (cituat më lart) dhe në faktin se parashtruesi i kërkesës *“nuk gjendet në posedim të ngastrave lëndore që nga viti 1956”* ndërsa padinë e tij e ka paraqitur më 14 maj 1997, respektivisht pas 41 vitesh.

57. Si përfundim, Komuna e Gjakovës i propozoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme duke qenë se, sipas saj, argumentet e paraqitura në kërkesën KI126/18 janë të pabazuara dhe në kundërshtim me gjendjen faktike. Gjykata Themelore, ajo e Apelit dhe Supreme, sipas pretendimit përfundimtar, kanë vendosur drejtë dhe në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke konstatuar se në rastin konkret padia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar.

Komentet e para të parashtruesit të kërkesës si përgjigje ndaj komenteve të Komunës së Gjakovës

58. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi komente shtesë lidhur me komentet e dorëzuara nga Komuna e Gjakovës.
59. Në komentet e tij shtesë, parashtruesi i kërkesës theksoi se komentimi i Komunës së Gjakovës *“është krejtësisht i pabazuar dhe angazhim që të na mohohet një e drejtë elementare në pronësi”*. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës ripërsëriti faktin që kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar me procedurë ligjore ose eksproprijim faktik nuk parashkruhet dhe lidhur me këtë ritheksoi vendimet e gjykatave të huaja të cilat i kishte paraqitur si prova në kërkesën e dorëzuar para kësaj Gjykate e të cilat ishin kontestuar nga Komuna e Gjakovës si prova jorelevante për vendimmarrjen e kësaj Gjykate.
60. Më tutje lidhur me këtë pikë, parashtruesi i kërkesës sqaroi se praktika gjyqësore e gjykatave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Serbi ishin bazuar në Ligjin për Eksproprijim që ishte plotësisht i ngjashëm me Ligjin e Kosovës për Eksproprijim dhe prandaj *“konsiderojmë se praktikën e cekura janë relevante edhe për këtë çështje”*. Parashtruesi specifikisht kërkoi që Gjykata Kushtetuese duhet të ketë parasysh nenin 41 të Ligjit nr. 03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
61. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës që ta shpallë kërkesën të pranueshme sipas petitumit të propozuar në kërkesën fillestare.

Komentet e dyta shtesë të Komunës së Gjakovës të 19 nëntorit 2018

62. Komuna e Gjakovës, në cilësinë e palës së interesuar, dorëzoi komente shtesë si përgjigje ndaj komenteve shtesë të parashtruesit të kërkesës.
63. Komuna e Gjakovës theksoi se ajo i kundërshton në tërësi të gjitha argumentet dhe provat e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës, duke theksuar se të tri

gjykatat e rregullta kanë vendosur drejtë dhe i kanë argumentuar vendimet e tyre me *“prova dhe fakte”*.

64. Më tutje, Komuna e Gjakovës thekson se mbështetja e parashtruesit të kërkesës në vendime të gjykatave të huaja, respektivisht rastin e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës (cituar më lart) dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kasacionit dhe të Apelit të Serbisë dhe praktikën gjyqësore lidhur me kompensimin për eksproprijimin faktik, janë vendime që *“nuk mund të kenë ndikim në këtë rast në procedurën para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ngase Kosova ka ligjet e veta të cilat janë zbatuar me përpikëri në këtë rast”*.
65. Lidhur me argumentin e parashtruesit të kërkesës se *“eksproprijimi faktik nuk parashkruhet”*, Komuna e Gjakovës thekson se një vlerësim i tillë nuk qëndron ngase gjykatat e rregullta të Kosovës me aktgjykimet e tyre në këtë rast *“drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës”*.
66. Si përfundim, Komuna e Gjakovës i propozoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme.

Pranueshmëria e kërkesës

67. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
68. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës si dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

[Parimet e Përgjithshme]

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara me Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

69. Në vazhdim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. *“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

70. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar e cila konteston akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin [Rev. nr. 197/2018] e 13 qershorit 2018 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, dhe se ka cekur të drejtat dhe liritë që i janë shkelur. Ai gjithashtu, e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit. Në rastin konkret, Bashkësia Islame e Gjakovës, në cilësinë e parashtruesit, është paraqitur si person juridik i cili kërkon mbrojtje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë kundrejt vendimmarrjes së një organi publik, në këtë rast Gjykatës Supreme. Rasti konkret ka të bëjë me një të drejtë civile, siç është e drejta e pronës dhe për këtë të drejtë civile ka pasur një kontest në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Komunës së Gjakovës. (Shih, për kontrast dhe krahasim, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI133/17, parashtrues *Ali Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019 mbi bazën e papranueshmërisë *ratione materiae* si dhe parimet e përgjithshme lidhur me domosdoshmërinë e ekzistimit të “një të drejte civile” dhe një “kontesti”, paragrafët 4-52).
71. Tutje, për sa i takon kriterëve të pranueshmërisë të parapara me nenin 48 të Ligjit, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës i ka sqaruar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij lidhur me shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së [pretendimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe nenin 46 të Kushtetutës [pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës].
72. Ndërkaq, për sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës së tyre për “mbrojtje gjyqësore të të drejtave” të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës dhe paragrafin 2 të nenit 22 të Kushtetutës dhe nenin 53 të

Kushtetutës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument se si këto dispozita kushtetuese janë shkelur nga gjykatat e rregullta që kanë vendosur për kërkesëpadinë e tij. Ajo thjesht i ka çekur këto nene dhe ka kërkuar nga Gjykata që të gjejë shkelje të tyre ose mbi bazën e tyre, duke mos dhënë asnjë arsyetim përkatës për bazueshmërinë e pretendimeve lidhur me to.

73. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që vetëm citimi neneve të Kushtetutës nuk mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit që rrjedh nga neni 48 i Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës ku kërkohet nga parashtruesit e kërkesës të qartësojnë *“saktësisht dhe në mënyrë adekuate [...] pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese”*. Andaj dhe rrjedhimisht, në linjë me praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, kjo e fundit, pretendimin e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës nuk do e trajtojë më tutje duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk e ka qartësuar saktësisht pretendimin e tij për shkeljen e kësaj dispozite kushtetuese (shih, në këtë aspekt, Aktvendimet për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese – ku janë refuzuar pretendime të ngjashme: K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, paragrafët 40-41; dhe K191/18, parashtrues *Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafët 52-54).
74. Për rrjedhojë, Gjykata në vazhdim do të shqyrtojë kriteret e tjera të pranueshmërisë vetëm për sa i takon pretendimit të parë, për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës. Lidhur me këto dy pretendime, tutje dhe bashkërisht, Gjykata do të shqyrtojë gjithashtu nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

75. Gjykata rikujton se i gjithë kontesti në fjalë ka të bëjë me dy prona të paluajtshme që në vitet e 50-ta kishin qenë dyqane në një rrugë qendrore në qytetin e Gjakovës. Të njëjtat, kishin qenë në pronësi të Bashkësisë Islame të Gjakovës; mirëpo, në një datë të pacaktuar, ato ishin konfiskuar nga organet e atëhershme publike dhe ishin shndërruar në trotuar publik. Në të tillë gjendje figurojnë dhe sot. Në vitin 2003, Bashkësia Islame e Gjakovës kishte riaktualizuar padinë e saj fillestare të vitit 1997, me ç’rast, përmes precizimit të padisë, kishte kërkuar nga gjykatat e rregullta që t’ia miratojnë kërkesëpadinë për kompensim dëmi për dy pronat [ish-dyqanet] në fjalë dhe atë në vlerë totale prej 17,750.00 euro. Komuna e Gjakovës, si palë e paditur nga parashtruesi i kërkesës, e kishte kundërshtuar padinë duke ngritur pretendimin se në rastin konkret kemi të bëjmë me *“parashkrim absolut”* të kërkesës ngase parashtruesi i kërkesës është paraqitur pas 41 (dyzetë e një) vitesh për të kërkuar të drejtat e pretenduara. Gjykatat e rregullta, të gjitha, ajo Themelore, e Apelit dhe Supreme, në thelb dhe në të njëjtën linjë arsyetimi, u pajtuan me këtë kundërshtim të Komunës së Gjakovës dhe vendosën që po, në fakt, në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim

absolut të kërkesës. Si rrjedhojë, kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës u refuzua pikërisht mbi bazën e parashkrimit absolut. Parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet dhe nuk konsideron se kërkesat për të drejtat pronësore mund të parashkruhen dhe, për rrjedhojë, e konteston vendimarrjen e gjykatave të rregullta para kësaj Gjykate.

76. Lidhur me këto procedura të zhvilluara para gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës, në substancë, para kësaj Gjykate ankohen se në rastin e tyre:

(i) gjykatat e rregullta i kanë shkelur atyre të drejtën e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për sa i përket detyrimit për arsyetim të vendimeve gjyqësore duke mos ofruar arsyetim të mjaftueshëm për refuzim të kërkesëpadisë së tij; dhe

(ii) gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtën e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës duke mos ia njohur të drejtën e tij në pronë dhe duke vendosur gabimisht se të drejtat pronësore mund të parashkruhen.

Përkitazi me shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për sa i takon arsyetimit të vendimeve gjyqësore

77. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, ku ata kryesisht theksojnë se Gjykata Supreme dhe e Apelit nuk i ka arsyetuar mjaftueshëm vendimet e tyre dhe nuk janë përgjigjur në pretendimet e tyre thelbësore të paraqitura në ankesë dhe revizion.
78. Në dritë të këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ia kishte refuzuar parashtruesit të kërkesës ankesën e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe më pas Gjykata Supreme ia kishte refuzuar kërkesën për revizion të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Sipas kësaj Gjykate, të dyja gjykatat e rregullta, respektivisht Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së si dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe praktikën gjyqësore të vet kësaj Gjykate. Të gjitha gjykatat e rregullta arsyetimin e të cilave parashtruesi i kërkesës e konteston për pamjaftueshmëri ishin përgjigjur në mënyrë të qartë në pretendimin thelbësor të të gjithë rastit e që kishte të bëjë me çështjen e parashkrimit absolut të kërkesës. Andaj dhe kjo Gjykatë konsideron se është i pabazuar dhe i pambështetur me argumente të mjaftueshme kushtetuese pretendimi i parashtruesit të kërkesës se ai nuk ka përfituar nga garancia kushtetuese për të marrë një vendim të arsyetuar gjyqësor.
79. Në mënyrë që të verifikojë saktë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mosarsyetim të vendimeve gjyqësore, Gjykata kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë kopjet e të gjitha ankesave të paraqitura në gjykata të rregullta – përfshi padinë; dhe, për më tepër, më pas, kishte kërkuar edhe dosjen

e plotë nga Gjykata Themelore. Të gjitha këto dokumente janë shqyrtuar nga Gjykata dhe pretendimet e paraqitura nga parashtruesi para gjykatave të rregullta dhe para kësaj Gjykate janë në detaje të reflektuara në paragrafët 41-51 të këtij Aktvendimi. Po aty, mund të shihen edhe pretendimet kryesore që parashtruesi i kërkesës i ka paraqitur në revizion.

80. Më konkretisht, siç shihet nga pjesa e fakteve ku gjerësisht reflektohet arsyetimi i Gjykatës së Apelit, kjo e fundit lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura kundrejt vendimmarrjes në Gjykatën Themelore kishte theksuar, në mes tjerash, se *“në rastin konkret nuk ekziston kërkesëpadi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, por vetëm për kompensim të kundërvlerës të ngastrave të paditësit të cilat siç u tha edhe më lart që nga viti 1956 janë në posedim dhe shfrytëzim të paditurës, Komunës së Gjakovës. Duke pasur parasysh faktin se në rastin konkret ekziston parashkrimi absolut i kërkesëpadisë, Gjykata e Apelit vlerësoi se pretendimet ankimore të paditëses janë të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, andaj, si të tilla u refuzuan në tërësi”*. Me fjalë të tjera, edhe Gjykata e Apelit, sikurse ajo Themelore, kishin arsyetuar gjithë bazën e refuzimit të rastit mbi faktin se kërkesa kishte arritur parashkrim absolut.
81. Më tutje, edhe Gjykata Supreme e kishte arsyetuar vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke u përgjigjur kështu në pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të paraqitura në revizion. Gjykata Supreme e konfirmoj se, sipas saj, nuk ka asnjë dyshim se kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës *“është parashkruar”* dhe, në këtë aspekt, pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës nuk dërgonin drejt vendosjes ndryshe të rastit.
82. Më konkretisht, Gjykata Supreme së pari kishte ripërsëritur faktet që kishin dërguar tek gjendja faktike e vërtetuar nga gjykatat e rregullta ku kishte vënë re që në mes palëve nuk kishte qenë kontestues fakti që dyqanet ishin shndërruar në trotuar në vitin 1956 dhe që si të tilla vazhdojnë të ekzistojnë. Po ashtu, Gjykata Supreme kishte theksuar se në një gjendje të tillë faktike: *“Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi është dashur që të argumentoj se është pronar i paluajtshmërisë lëndore, për të cilën ka kërkuar kompensim, në bazë të padisë për vërtetimin e pronësisë dhe kthimin e saj. Mirëpo paditësi [parashtruesi i kërkesës] nuk ka vepruar kësi soji, edhe pse nuk gjendet në posedim të ngastrave lëndore që nga viti 1956, ndërsa padinë me kërkesë që t'i paguhet kundërvlera e këtyre ngastrave e paraqet në gjykatë me datën 14.05.1997. Duke marrë parasysh kundërshtimin e të paditurës [Komunës së Gjakovës] për parashkrim, gjykata e shkallës së parë vlerëson se kërkesa e paditësit që të obligohet e paditura për pagesën e kundërvlerës së këtyre ngastrave është parashkruar në kuptim të nenit 371 të LMD-së, për të cilën arsye ka vendosur në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj”*.
83. Tutje dhe së dyti, Gjykata Supreme, lidhur me pretendimet e paraqitura në revizion kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës vetëm në mënyrë të përgjithshme ka theksuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe nuk ka *“sqaruar konkretisht se cilat janë ato”*. Sipas Gjykatës Supreme, parashtruesit e kërkesës vetëm kanë përmendur por nuk kanë sqaruar se ku qëndron kontradikta në mes të dispozitivit dhe arsyetimit. Ndërkaq, përkitazi me arsyet për sa i takon fakteve

vendimtare, sipas Gjykatës Supreme, “gjykata e shkallës së parë dhe të dytë kanë dhënë arsye të mjaftuara për faktin relevant për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike që ka të bëjë me parashkrimin e kërkesës së paditësit për pagesë të kundërvlerës së ngastrave lëndore, të cilat arsye i pranon edhe gjykata e revizionit, andaj është e panevojshme që edhe tani të përsëriten, kështu që kjo gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale sa i përket aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë”.

84. Së treti, për sa i takon pretendimeve në revizion lidhur me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme i konsideroj të njëjtat si të pabazuara. Më specifikisht në këtë aspekt, Gjykata Supreme arsyetoi se: “*Pretendimi i paditësit se ngastrat lëndore janë pronë e paditësit ngase evidentohen në emër të tij në evidenca kadastrale, është i pabazuar, kjo ngase në rastin konkret nuk gjykohet sipas padisë së paditësit lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe kthimit në posedim, por në rastin konkret procedura kontestimore është zhvilluar sipas padisë së paditësit për pagesën e kundërvlerës së ngastrave lëndore, kështu që në këtë situatë pretendimet e paditësit për pronësi në këto ngastra janë irelevante*”.
85. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, për praktikë të përditësuar gjyqësore, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafët 50-52; shih po ashtu, parimet themelore për sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të elaboruara edhe në rastet e tjera të kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, me parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; dhe KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; më tutje, shih po ashtu edhe disa nga rastet kryesore të GJEDNJ-së mbi të cilat është ndërtuar praktika e Gjykatës Kushtetuese lidhur me të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësorë: *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007).
86. Sipas parimeve të lartcekura, e të cilat janë tashmë pjesë e praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, me rastin e refuzimit të një ankese, apo siç është rasti konkret një kërkesë për revizion, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët, në këtë rast Gjykatës së Apelit. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19

dhjetorit 1997, Raportet 1997-VIII, paragrafët 59-60; shih po ashtu praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të cituar në paragrafin më lart).

87. Ngjashëm dhe në po këtë linjë arsyetimi, Gjykata po ashtu rikujton se rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë apo e Apelit konfirmon vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore – me të cilat është refuzuar padia për kompensim dëmi - por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme në mënyrë të drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike dhe vendimmarrja në Apel dhe në Themelore ishte në përputhje me të drejtën materiale dhe procedurale për sa i përket parashkrimit absolut të kërkesës së parashtruesit. Pra, Gjykata Supreme ka konfirmuar plotësisht arsyetimin e dy gjykatave të rregullta sipas së cilave parashtruesi i kërkesës është dashur me kohë të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij dhe këtë gjë ta bëjë para se kërkesa e tij të parashkruhet në baza absolute sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
88. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në çdo pikë të ngritur nga parashtruesit e kërkesës në kërkesën e saj për revizion (shih rastin e GJEDNJ: *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61), ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës për sa i përket zbatimit të së drejtës materiale dhe shkelje të mundshme procedurale (shih rastin e GJEDNJ-së: *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Duke vepruar kështu, Gjykata Supreme e ka përmbushur obligimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet kësaj Gjykate.
89. Gjykata më tej konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në Gjykatën e Apelit kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës materiale apo procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit, material dhe procedural - edhe në aspekt të çështjes së parashkrimit - është detyrë parësore e gjykatave të rregullta dhe si e tillë është, në parim, çështje e ligjshmërisë. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62). Është obligim dhe barrë e parashtruesit të kërkesës që të bindë Gjykatën se pretendimet e tij nuk janë thjesht pretendime të “ligjshmërisë” por që, në fakt, të njëjtat ngrehin “çështje të kushtetutshmërisë”. E, në këtë rast, ky nuk është rasti ngase parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të bindë Gjykatën se argumentet e tij shkojnë përtej fushës së ligjshmërisë.

90. Pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurave para gjykatave të rregullta, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21,; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
91. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij se procedurat përkatëse për refuzimin e kërkesëpadisë së tij për kompensim dëmi në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
92. Andaj, si rezultat, pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për çështje të arsytimit të vendimeve gjyqësore, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese. Si i tillë, ky pretendim duhet të refuzohet mbi bazën e rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

Përkitazi me shkeljen e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për sa i takon mbrojtjes së pronës

93. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës ku ajo kryesisht thekson se “*ka qenë dhe vazhdon të jetë i regjistruar si pronar*” i ngastrave kontestuese kadastrale, respektivisht ish-dyqaneve që tashmë janë trotuar. Tutje, ajo thekson se gjykatat e rregullta e kanë vërtetuar se prona është e parashtruesit të kërkesës dhe se e njëjta është “*pronë vakfnore*” për të cilën nuk janë zhvilluar procedura për shpronësim të pronës private për nevoja publike apo ajo e kompensimit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në çështjen e tij “*parashkrim nuk ka*” dhe se nuk është faji i tij por i autoriteteve publike që nuk janë zbatuar ligjet në mënyrë të drejtë dhe që nuk janë iniciuar procedurat e duhura të shpronësimit. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës sërish pretendon se gjykatat e rregullta “*nuk kanë dhënë arsye të qarta lidhur me pretendimet ankimore dhe të revizionit*” dhe se duke mos “*arsyetuar aktgjykimet, kanë vepruar me njëanshmëri, kanë shkelur të drejtën e pronës*”.
94. Për sa i takon pretendimeve për mosarsyetim të vendimeve gjyqësore, e të cilat parashtruesi i kërkesës i ndërlidhë sërish edhe në pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës, Gjykata rikujton arsytimin e mësipërm të saj ku edhe u theksua se gjykatat e rregullta i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese për arsyetim të vendimeve gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që ta bind Gjykatën se cili ka qenë pretendimi qenësor i saj i cili është paraqitur dhe nuk është adresuar. Rrjedhimisht, të gjitha pretendimet për mos arsyetim të vendimeve gjyqësore të gjykatave të rregullta, kjo Gjykatë veçse i ka

shpallur si pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe të njëjtave nuk do ju kthehet sërish dhe për së dyti.

95. Ndërkaq, për sa i takon të drejtës për mbrojtje të pronës, Gjykata fillimisht citon dispozitën e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, në të cilat parashihet me sa vijon:

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës

“1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet. [...]”.

Neni 1 [Mbrojtja e Pronës] i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

96. Gjykata vëren se neni i lartcekur ka gjithsej 3 paragrafë. Në të parin paragraf, parashihet, në mënyrë të përgjithshme, se e drejta e pronës është e garantuar me Kushtetutë. Në të dytin paragraf, sanksionohet se shfrytëzimi i pronës nga ana e pronarëve të pronave - qofshin ata persona fizikë apo juridikë - rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik. Në fjalinë e parë të të tretit paragraf, qartësohet se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Në fjalinë e dytë të të tretit paragraf, bëhet e ditur që e drejta në pronë nuk është një e drejtë absolute por një e drejtë e kualifikuar e cila, në kushte të caktuara, mund edhe të eksproprijohet. Eksproprijimi i pronës duhet të jetë i autorizuar me ligj, të jetë i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e një qëllimi publik dhe të përcjellët me mekanizma adekuat të kompensimit të menjëhershëm.
97. Në këtë drejtim, Gjykata po ashtu vëren se GJEDNJ, në interpretim të nenit 1 të Protokollit nr. 1, ka konstatuar se e drejta e pronës përbëhet nga tri rregulla të ndryshme. Rregulli i parë, i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pasurisë; kjo përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Rregulli i dytë përfshin privimin nga pasuria dhe ia nënshtrohet të njëjtin kushteve të caktuara; kjo përcaktohet në fjalinë e dytë të të njëjtit paragraf. Rregulli i tretë ua njeh shteteve, ndërmjet të

tjerash, të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ato ligje që ato i çmojnë të nevojshme për këtë qëllim; kjo përcaktohet në paragrafin e dytë (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 shtatorit 1982, *Sporrong dhe Lonngrot kundër Suedisë*, nr. 7151/75; 7152/75, para. 61).

98. Të tri rregullat nuk janë, megjithatë, “të ndryshme” në kuptimin e të qenët të pandërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe, prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, paragrafi 37).
99. Në këtë aspekt, duke vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme në frymën e pretendimeve për shkelje kushtetuese dhe fakteve të prezantuara nga parashtruesi dhe ato që Gjykata i ka vënë re nga dosja e plotë, Gjykata konstaton se fakti që kërkesa e parashtruesit është refuzuar, në aspekt procedural, për parashkrim absolut të kërkesëpadisë – nuk rezulton në shkelje të së drejtës në pronë e as në gëzim paqësor të saj. Ajo çfarë parashtruesi i kërkesës në thelb bën me kërkesën e tij, është të kontestojë mënyrën e zbatimit të ligjeve në fuqi nga gjykatat e rregullta për sa i takon shpalljes së kërkesëpadisë si të parashkruar.
100. Në këtë drejtim, Gjykata po ashtu rikujton që në procedurat para gjykatave të rregullta nuk ishte kontestuese fakti që parashtruesi kishte qenë pronar i dy dyqaneve në fjalë në vitet e 50-ta. Po ashtu, nuk ishte kontestuese fakti që ato iu ishin konfiskuar atij. Pra, në rastin konkret, kishte një “ndërhyrje” [“*interference*”] në të drejtën e pronës së parashtruesit nga ana e autoriteteve publike të asaj kohe. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se gjykatat e rregullta nuk kishin vendosur asnjëherë në mënyrë meritore lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës ngase ai e kishte dorëzuar atë pas 41 (dyzetë e një) vitesh nga momenti që kishte ndodhur eksproprijimi i pronës së tij. Domethënë, pretendimet e saj për eksproprijim të paligjshëm dhe pa kompensim, ajo i kishte paraqitur në një afat kohor të vonuar – sipas arsyetimit të gjykatave të rregullta.
101. Në këtë aspekt, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës në pronë janë ndërtuar mbi bazën e asaj se a duhet apo jo të ketë parashkrim absolut për kërkesën e saj. Kjo çështje, dhe ashtu siç është ngritur dhe argumentuar nga parashtruesi i kërkesës – paraqet çështje të ligjshmërisë dhe si e tillë, në parim, nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.
102. Siç edhe është e ditur nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, nuk është detyrë e kësaj të fundit që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër – në rastin konkret ligjin që kishte të bëjë me parashkrimin absolut të kërkesës së parashtruesit. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në

- juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
103. Në fund, lidhur me çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronës së marrë nga regjimet apo autoritetet e kaluara, Gjykata rikujton arsyetimin e saj të dhënë në disa raste të tjera para saj ku dhe janë theksuar parimet e përgjithshme në këtë aspekt. (Shih rastin KI78/18, *parashtues Pashk Malota*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 shkurtit 2019 - ku citohet praktika e GJEDNJ-së për rastet e kthimit të pronës, respektivisht: Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 4 marsit 2003, *Jantner kundër Sllovakisë*, nr. 39050/97, paragrafi 34; Aktgjykimi i GJEDNJ-së [DHM], i 10 korrikut 2002, *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, nr. 39794/98, paragrafët 70-74).
104. Në rastin KI78/18, në paragrafët 49-53, Gjykata, në mes tjerash, ka potencuar se KEDNJ dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së: "(i) nuk i obligon Shtetet Kontraktuese që të nxjerrin një Ligj për kthimin e pronës; (ii) iu lejon Shteteve Kontraktuese liri të konsiderueshme në vendosjen dhe determinimin e fushëveprimit të kthimit të pronës dhe zgjedhjen e kushteve të aplikueshme për një gjë të tillë; (iii) iu mundëson Shteteve Kontraktuese të përcaktojnë dhe/ose përjashtojnë kategori të caktuara nga e drejta për kthim të pronës; dhe (iv) i obligon Shtetet Kontraktuese që, në rastet kur vet kanë vendosur që të nxjerrin ligj për kthimin e pronës, të respektojnë të drejtën për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së meqë në raste të tilla mbrojtja nga ky nen është e drejtë e garantuar me KEDNJ. Këto janë katër parimet e përgjithshme lidhur me çështjen e "kthimit të pronës", në bazë të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, tashmë të konsoliduar në këtë drejtim".
105. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se në Republikën e Kosovës nuk ka një ligj të veçantë për kthim të pronave dhe si rrjedhojë kërkesat për kthim të pronave nuk mund të bazohen në garancitë që i ofron neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së apo, *mutatis mutandis*, në garancitë e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Kjo, siç u shpjegua më lart, për arsyen e vetme që kërkesat për kthim të pronave nuk mund të konsiderohen se përbëjnë një "pritje legjitime" përderisa nuk ekziston një ligj i veçantë për kthim të pronave.
106. Andaj, si rezultat, pretendimi i parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, për çështje të mbrojtjes së pronës, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese. Si i tillë, ky pretendim duhet të refuzohet mbi bazën e rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.
107. Krejt në fund, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës i mbështetë pretendimet e tij edhe duke iu referuar vendimeve të ndryshme të gjykatave të huaja, specifikisht Gjykatës Supreme të Serbisë [shih, Vendimin Rev. nr. 1580/98, të 24 qershorit 1998 si dhe vendimin (pa numër) të 28 dhe 29 majit 1986], vendimeve të gjykatave në Bosnje dhe Hercegovinë si dhe disa ligjeve të

publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, siç janë Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore i 8 dhjetorit 1997 dhe Ligji për Eksproprijimin (pa datë, i publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53/95).

108. Lidhur me këto pretendime, Gjykata rikujton qëndrimin e saj të paraqitur në Aktgjykimin KI48/18 ku specifikisht thuhet se: *“Vendimet e gjykatave të tjera nuk përbëjnë burim të së drejtës në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe të njëjtat mund të përdoren vetëm për çështje krahasimore dhe për qëllime të determinimit të ekzistencës së një konsensusi lidhur me një çështje të caktuar në nivel evropian apo botëror”*. Tutje, në të njëjtin Aktgjykim të Gjykatës po ashtu specifikohet qëndrimi dhe interpretimi kushtetues sipas të cilit: *“statusin e burimit të së drejtës në sistemin juridik të Republikës së Kosovës e kanë vetëm vendimet e GJEDNJ-së.”* (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI48/18, parashtrues Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafët 275-277). E njëjta linjë arsyetimi vlen edhe për ligjet e vendeve të tjera të cilat janë cituar nga parashtruesi i kërkesës.
109. Në këtë aspekt, Gjykata, për rrethanat e rastit konkret, vëren që parashtruesit e kërkesës kanë cekur dhe kanë cituar këto vendime të gjykatave të huaja dhe ligjet e një shteti të huaj të cilët ata i kanë konsideruar si relevante për rastin e tyre dhe të ngjashme me rrethanat e rastit konkret, mirëpo ata nuk kanë elaboruar lidhshmërinë e tyre, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret e as nuk kanë argumentuar se si të njëjtat janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Gjykata rikujton, për fund, edhe qëndrimin e saj se të gjitha *“arsyetimet e gjykatave të tjera kushtetuese [supreme] apo edhe ndërkombëtare duhet të interpretohen në kontekstin e garancive kushtetuese dhe ligjore dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë”*. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI48/18, cituar më lart, paragrafi 276).

Përmbledhje

110. Gjykata, si përfundim vendos që:

- (i) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me arsyetim të vendimeve gjyqësore janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;
- (ii) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përkitazi me të drejtën e pronës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;
- (iii) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 22 paragrafi 2, nenit 53 dhe nenit 54 të Kushtetutës për sa i përket çështjes së mbrojtjes gjyqësore të të drejtave nuk janë të qartësuara në mënyrë adekuate dhe si të tilla duhet të refuzohen në bazë të nenit 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 39 (1) (d) dhe 39 (2) të Rregullores së punës, më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi